

Број: 02-684/1

05.05 26

## Procesverbali i mbledhjes së Këshillit të nxënësve

Data: 5.5.2026

Ora: 11.00

Vendi: Kabineti i gjuhëve

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28.4.2026;
2. Llojet e konflikteve dhe zgjidhja efektive e tyre përmes komunikimit të duhur;
3. Raporti mbi aktivitetet e zbatuara të Këshillit të nxënësve.

Mbledhja u kryesua nga Kryetarja e Këshillit të nxënësve Kristina Krajçeva në prani të njëzet e dy kryetarëve të klasave dhe anëtarëve të emëruar të shërbimit profesional dhe mësimdhënësve, Elena Petrovska, Mimoza Giçevska dhe Halime Demir-Horuni. Pas miratimit të rendit të ditës, procesverbali i seancës së mëparshme të mbajtur më 28.4.2026 u miratua unanimisht.

Në kuadër të pikës së dytë të rendit të ditës, psikologjia mbajti një punëtori me temë "*Llojet e konflikteve dhe zgjidhja efektive e tyre përmes komunikimit të duhur*". Gjatë punëtorisë, nxënësit u njohën me konceptin e *konfliktit*, llojet e konflikteve që ndodhin më shpesh në jetën e përditshme dhe në shkollë, si dhe arsyet e shfaqjes së tyre. Fyerjet, mendimet e ndryshme dhe komunikimi i papërshtatshëm janë shkaqe të zakonshme të konfliktit midis nxënësve. Përmes diskutimit dhe shembujve, nxënësit mësuuan se si konfliktet mund të zgjidhen në mënyrë paqësore dhe efektive duke përdorur komunikimin e duhur, respektin për bashkëbiseduesin, dëgjimin aktiv dhe mirëkuptimin e ndërsjellë. U theksua rëndësia e kontrollit të emocioneve, shmangia e fyerjeve dhe sjelljeve të dhunshme, si dhe nevoja për bashkëpunim dhe tolerancë në komunikimin e përditshëm.

Nxënësit morën pjesë aktive në punëtori, shprehën mendimet, përvojat dhe shembujt e tyre nga jeta e përditshme, duke kontribuar kështu në zbatimin e suksesshëm të aktivitetit.

Pas pikës së tretë të rendit të ditës, u shqyrtua raporti për aktivitetet e zbatuara të Këshillit të nxënësve. Anëtarët e pranishëm diskutuan aktivitetet e zbatuara dhe miratuan njëzëri raportin.

Kryetare e Këshillit të nxënësve:

Kristina Krajçeva



Sekretare e Këshillit të nxënësve:

Anxhela Filipoviq



Përktheu:

Jehona Asani

